



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore te Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR: 1

NR i VENDIMIT.:
DATA E VENDIMIT:

KPCC/D/R/152/2012
19/04/2012

Komisioneret Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

(1) Në secilën prej 29 (njëzet e nëntë) kërkesave të identifikuara në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të hidhet poshtë.

(2) Në secilën prej 23 (njëzet e tri) kërkesave të identifikuara në pjesët C dhe D të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të refuzohet.

(3) Në kërkesat me nr. 01130, 22267, 41455, 47602, 54575 ,54576 dhe 54577, të referuara në pjesët A, C dhe D të listës së bashkangjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të hidhen poshtë kur paraqitësit e kërkesave kërkojnë kompensim për dëmin material apo për humbjen e shfrytëzimit, të pronës së kërkuar.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin i themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi i kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të

Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

5. Komisioni mbajti seancën e njëzet e tetë nga 17 deri 19 prill 2012 në Prishtinë. Komisionit i janë paraqitur gjithsej 231 kërkesa për pronë banesore në seancën e njëzetë e tetë nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante. Një kërkesë për pronë banesore, e cila i ishte paraqitur Komisionit, iu kthye Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni për verifikim të mëtejshëm. Komisioni ndërpreu shqyrtimin e tri kërkesave banesore në pritje të mbajtjes së seancës dëgjimore. Gjithsej 227 kërkesa për pronë banesore u vendosën nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesat të përfshira në këtë vendim.

7. Në kërkesat e përfshira në këtë vendim, me përjashtim të kërkesave nr. 00876, 11795, 17897, 29210 dhe 44729, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësinë. Të gjitha kanë të bëjnë me pronat banesore, përfshirë tokën e bashkuar. Në kërkesat nr. 00876, 11795, 17897, 29210 dhe 44729, paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit për pronën e kërkuar.

8. Ky vendim përfshin 52 kërkesa për pronë banesore të cilat janë të shënuara në pjesët A, B, C dhe D të listës së bashkangjitur. Pjesa e mbetur prej 175 kërkesave për pronë banesore përfshihen në vendimet KPCC/D/R/150/2012 dhe KPCC/D/R/151/2012.

9. 33 kërkesat e shënuara në pjesët B dhe D të listës së bashkangjitur janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat e kërkuara ose pala që ka shprehur interes ligjor në këto prona ("pala përgjegjëse") e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079..

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksit e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksit e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legislative dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksit I, II dhe III, respektivisht.

10. Nëntëmbëdhjetë kërkesat e shënuara në pjesën A dhe C të listës së bashkangjitur këtij vendimi janë jokontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm, të shfrytëzimit apo kultivimit të këtyre pronave nga ndonjë person ose, edhe kur ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Vendimet që janë marrë në kërkesat që janë notifikuar pasaktësisht janë shfuqizuar nga Komisioni për të siguruar notifikimin e saktë të pronave dhe për t'i ofruar cilitdo person që mund të ketë interes ligjor në pronë, me mundësinë për të dhënë përgjigje për kërkesën në pajtim me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Këto kërkesa janë identifikuar në kolonat përkatëse të listës së bashkangjitur këtij vendimi. Sekretaria Ekzekutive ka notifikuar kërkesat në mënyra të ndryshme duke përfshirë notifikimin fizik të pronës, dhe/ose me anë të notifikimit të pronës përmes publikimit në gazeta zyrtare dhe gazeta, përmes autoriteteve vendore komunale, gjykatave vendore, udhëheqësve vendorë në fshat dhe institucioneve përkatëse në Kosovë dhe Serbi. Bazuar në informacionet e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur që Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, për të njoftuar personat të cilët aktualisht mund t'i kenë uzurpuar pronat, dhe persona tjerë të cilët mund të kenë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohet nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

B. Kërkesa të hedhura poshtë.

11. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 Komisioni hedh poshtë të gjithë ose një pjesë të kërkesës kur:

- (a) Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të depozitojë kërkesë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;
- (b) Kërkesa nuk është në fushëveprimin e juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronave;
- (c) Kërkesa është shqyrtuar edhe vendosur më parë në një vendim administrativ ose gjyqësor të formë së prerë.

12. Neni 8.6 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 i jep Komisionit kompetencat të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze duke përfshirë edhe ato të përcaktuara me nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

13. Kërkesat të cilat janë hedhur poshtë për shkak se bien jashtë juridiksionit të Komisionit ose për arsye procedurale dhe jo për shkak të meritave të kërkesës, mund të vendosen nga gjykatat vendore në bazë të ligjit në fuqi. Në vendime të tilla vendimi i Komisionit nuk është *res judicata*. Neni 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 konfirmon të drejtën e paraqitësve të kërkesave që të ndjekin kërkesat që nuk bien në mandatin e Komisionit para gjykatave me kompetencë juridiksionale ashtu si përcaktohet në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. (Shih gjithashtu nenin 8.1 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 në lidhje me

kompetencat e Komisionit për të referuar çështjet që lindin në lidhje me kërkesat të cilat nuk janë nën juridiksionin e tij një gjykatë vendore ose një bordi administrativ apo tribunalit.).

14. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesat pronësore që ndërlidhen me konfliktin në kuptimin që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë pronësore. Për të vërtetuar se a është kërkesa brenda juridiksionit të tij apo jo, Komisioni duhet të përcaktojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, është zhvendosur nga prona e kërkuar, ose nëse e ka humbur posedimin apo kontrollin mbi pronën e tillë, si pasojë e konfliktit. Komisioni gjithashtu duhet të vërtetojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj për pronën e kërkuar.

15. Ndonëse Komisioni ka pikëpamjen se humbja e posedimit që ka ndodhur përtej periudhës 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 megjithatë mund të konsiderohet që ndërlidhet drejtpërsëdrejti me, apo që është pasojë e konfliktit, varësisht nga rrethanat e rastit, ai duhet të konstatojë se ka disa dëshmi që tregojnë se humbja e posedimit përfshin rrethanat që janë pasojë e konfliktit.

1. Kërkesa të hedhura poshtë për shkak të mungesës së juridiksionit

a. Kërkesa nr. 00876

16. Kërkesa nr. 00876 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit për pronën e kërkuar. Megjithatë, bazuar në dëshmitë e paraqitura, paraqitësi i kërkesës ka përfutur posedimin e pronës së kërkuar vetëm pas konfliktit të vitit 1998-99. Paraqitësi i kërkesës deklaroi gjithashtu se ka humbur posedimin e pronës së kërkuar vetëm në prill të vitit 2005. Rrjedhimisht nuk ka humbje të posedimit për pronën e kërkuar për shkak të konfliktit 1998-99, dhe kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi bie jashtë juridiksionit të Komisionit.

b. Kërkesa nr. 22204

17. Kërkesa nr. 22204 u paraqit nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë dokument në mbështetje të kërkesës. Fleta poseduese e verifikuar *ex officio* nga Sekretaria Ekzekutive, e tregon një person tjetër e jo paraqitësin e kërkesës si pronar të pronës së kërkuar. Gjatë procesit të notifikimit, prona u konstatua se shfrytëzohej nga paraqitësi i kërkesës. Rrjedhimisht, ndonëse paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë të drejtën pronësore për pronën e kërkuar ai ka mundësinë ta shfrytëzojë pronën e kërkuar. Në këtë rrethanë, kërkesa duhet të hidhet poshtë për mungesë të juridiksionit.

c. Kërkesa nr. 42188

18. Kërkesa nr. 42188 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore ku kërkon konfirmimin e pronësisë për pronën e kërkuar. Më pas, paraqitësi i kërkesës pranoi se nuk ishte zhvendosur për shkak të konfliktit në Kosovë dhe nuk e kishte humbur kurrë posedimin e pronës. Ai deklaroi se ishte larguar nga Kosova në vitin 2002 për shkak të situatës së vështirë dhe mungesës së mundësive në fshatin e tij. Ai konfirmoi se nuk ishte kërcënuar për t'u larguar nga fshati dhe mund të kthehet në pronën e kërkuar në çdo kohë. Ndërkohë i kishte dhënë leje nipit të tij për ta shfrytëzuar pronën. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se e depozitoi kërkesën për qëllimin e përfitimit të konfirmimit të së drejtës ligjore për pronën.

19. Rrjedhimisht, në mungesë të humbjes së posedimit për pronën e kërkuar për shkak të konfliktit të 1998-99, kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi bie jashtë juridiksionit të Komisionit.

d. Kërkesa nr. 50461

20. Kërkesa nr. 50461 është depozituar nga përfaqësuesi i autorizuar në emër të paraqitësit të kërkesës, i cili kërkon pronën në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëshortit të saj. Përfaqësuesi i autorizuar i mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore u kontaktua disa here nga Sekretaria Ekzekutive dhe iu kërkua të paraqitë dokumentacion për të drejtën pronësore të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Përfaqësuesi i autorizuar shpjegoi se mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore e ka blerë pronën nga një pale e tretë, por se transaksioni nuk ishte zbatuar ende. Përfaqësuesi i autorizuar tregoi se do të dorëzonte kontratën e blerjes, megjithatë ai dështoi ta bëjë këtë.

21. Gjatë rrjedhës së notifikimit të pronës së kërkuar, Sekretaria Ekzekutive konstatoi një shtëpi të re të ndërtuar në pronën e kërkuar. Paraqitësi i kërkesës pranoi se prona e kërkuar nuk është uzurpuar në mënyrë të paligjshme dhe se familja e saj e viziton pronën here pas here. Rrjedhimisht, ndonëse paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë të drejtën pronësore për pronën e kërkuar, ai ka mundësinë ta shfrytëzojë pronën e kërkuar. Kështu, kërkesa duhet të hidhet poshtë për mungesë të juridiksionit.

e. Kërkesat nr. 92432 dhe 92433

22. Kërkesat nr. 92432 dhe 92433 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Nisur nga mospërputhja e emrit të mbajtësit të së drejtës pronësore në dokumente të ndryshme (Petar/Petrus dhe Pavle/Pave), Komisioni në seancën e 8 të KKKP-së me 25 gusht 2008, ia ktheu kërkesën Sekretarisë Ekzekutive për sqarimin e kësaj çështje.

23. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi paraqitësin e kërkesës më 8 maj 2009 dhe i kërkoi atij të paraqitë një dokument të vërtetuar nga zyra e regjistrimit të gjendjes civile në lidhje me mospërputhjen e emrit ose të ofronte një fletë poseduese të re me emrin e tanishëm të mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës i kërkoi Komision të pezullojë përpunimin e kërkesës derisa të përfundohej procedura e

trashëgimisë pasi ai donte të vazhdonte me kërkesat që lidheshin me pronën e tij. Sekretaria Ekzekutive u përpoq të kontaktojë paraqitësin e kërkesës disa here, por u njoftua nga djali dhe reja e tij se ai ishte vendosur në Moskë në Federatën Ruse. Pavarësisht kërkesave të përsëritura për të ofruar dokumentet e kërkuara për të shpjeguar mospërputhjen e emrit, ai dështoi ta bëjë këtë. Rrjedhimisht kërkesat duhet të hidhen poshtë. Komisioni vëren se me pare i ka hedhur poshtë kërkesat e paraqitësit të kërkesës mbi të njëjtën bazë; shih vendimin e Komisionit KPCC/D/A/142/2012 të datës 29 shkurt 2012, paragrafët. 52-53.

2. Kërkesa të hedhura poshtë për shkak të mungesës së autorizimit

24. Në të dy kërkesat e përfshira në këtë seksion, paraqitësit e kërkesave kanë dështuar të depozitojnë kërkesë të plotë në përputhje me procedurën e përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Rrjedhimisht këto kërkesa duhen të hidhen poshtë.

a. Kërkesa nr. 28989

25. Kërkesa nr. 28989 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht hallës/tezes së tij. Paraqitësi i kërkesës nuk ofroi autorizim të vlefshëm nga mbajtësi i së drejtës pronësore ose anëtari i bashkësisë familjare.

b. Kërkesa nr. 52022

26. Kërkesa nr. 51022 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht vjehrrës së saj. Paraqitësi i kërkesës pretendon se mbajtësi i së drejtës pronësore ka vdekur, por nuk është paraqitur asnjë dëshmi relevante madje as Sekretaria Ekzekutive nuk ka gjetur ndonjë dokument të tillë. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi paraqitësin e kërkesës disa here edhe i kërkoi të ofronte autorizim nga anëtari i bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës tregoi se do ofronte autorizimin e kërkuar por dështoi ta bëjë këtë.

3. Tjetërsimi vullnetar ose mundësia për të ushtruar të drejtën pronësore

27. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim, fillimisht paraqitësit e kërkesave pretenduan se familjet e tyre i humbën pronat e kërkuara si rezultat i konfliktit të vitit 1998-1999. Megjithatë, me vonë, paraqitësi e kërkesave e informuan Sekretarinë Ekzekutive se ata ose familjet e tyre sipas rastit, i tjetërsuan pronat vullnetarisht. Fakti që paraqitësit e kërkesave ose mbajtësit e së drejtës pronësore sipas rastit, kanë pasur mundësi të shesin pronat e kërkuara tregon se ata kanë qenë në situatë të ushtrojnë të drejtat pronësore në kuptim të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Rrjedhimisht këto kërkesa duhet të hidhen poshtë.

a. Kërkesa nr. 13919

28. Në kërkesën nr. 13919 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore,

pikërisht bashkëshortit të saj. Me pas, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se prona e kërkuar ishte shitur në vitin 2011, megjithatë ai nuk dëshiroi ta tërheqë kërkesën.

b. Kërkesa nr. 17078

29. Në kërkesën nr. 17078 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse pretendon se ai po e shfrytëzon pronën me lejen e mbajtësit të së drejtës pronësore. Me pas, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se e kishte shitur pronën në vitin 2011 tek një pale e tretë dhe mohoi t'i ketë dhënë lejen ndonjë personi tjetër. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se do ta tërhiqte kërkesën por dështoi ta bëjë këtë.

c. Kërkesa nr. 22484

30. Në kërkesën nr. 22484 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Fillimisht paraqitësi i kërkesës kërkoj konfirmimin e së drejtës pronësore, megjithatë më pas pranoi se e kishte shitur pronën e kërkuar në vitin 2007. Ai tregoi se do ta tërhiqte kërkesën, megjithatë ai dështoi ta bëjë këtë.

d. Kërkesa nr. 25547

31. Në kërkesën nr. 25547 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Më pas, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se ia kishte shitur pronën e kërkuar palës përgjegjëse në vitin 2007. Kërkesa nuk është tërhequr.

e. Kërkesa nr. 25548

32. Në kërkesën nr. 25548 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Me pas paraqitësi i kërkesës konfirmoi se shtëpia e kërkuar ishte shitur në vitin 2007, por nuk e tërhoqi kërkesën.

f. Kërkesa nr. 30669

33. Kërkesa nr. 30669 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të ndjerë të së drejtës pronësore. Fillimisht paraqitësi i kërkesës kërkoj konfirmimin e pronësisë për pronën e kërkuar. Megjithatë, më pas konfirmoi se prona e kërkuar u shit në vitin 2011. Kërkesa nuk është tërhequr.

g. Kërkesa nr. 47602

34. Në kërkesën nr. 47602 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Më pas, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se parcela e kërkuar është shitur në vitin 2007. Kërkesa nuk është tërhequr.

h. Kërkesa nr. 50445

35. Kërkesa nr. 50445 u depozitua nga përfaqësuesi i autorizuar në emër të paraqitësit të kërkesës i cili e paraqiti kërkesën në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Fillimisht paraqitësi i

kërkesës konfirmoi pronësinë për pronën e kërkuar, me pas ai pranoi se e kishte shitur atë. Nuk është bërë asnjë tërheqje.

i. Kërkesat nr. 50452 dhe 50456

36. Kërkesa nr. 50452 është depozituar nga përfaqësuesi i autorizuar nga paraqitësi i kërkesës, i cili ka bërë kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëshortit të saj. Kërkesa nr. 50456 është paraqitur nga i njëjti përfaqësues i autorizuar në emër të paraqitësit të kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Të dy kërkesat janë paraqitur në lidhje me të njëjtën shtëpi për dy bashkëpronarë të ndryshëm të pretenduar, Predrag dhe Novica Ilic, të cilët pretendojnë se e kanë blerë pronën e kërkuar nga Borivoje Mitic para konfliktit. Paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese që e tregon Borivoje Mitic si mbajtësin e së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës dështoi të paraqitë dëshmi në mbështetje të shitjes së pretenduar. Sekretaria Ekzekutive gjeti *ex officio* certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme që e tregon Dragisa (Borivoj) Mitic si pronar të pronës së kërkuar. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi disa here paraqitësin e kërkesës dhe përfaqësuesin e autorizuar duke iu kërkuar të ofrojnë dokumente shtesë për të dëshmuar të drejtën e pretenduar pronësore, megjithatë, ata dështuan ta bëjnë këtë. Gjatë një bisede telefonike më 20 mars 2012, djali i bashkëpronarit të pretenduar deklaroi se prona e kërkuar i ishte shitur një pale të tretë. Megjithatë kjo kërkesë nuk është tërhequr.

j. Kërkesa nr. 53704

37. Kërkesa nr. 53704 u paraqit nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Pala përgjegjëse pohoi se e kishte blerë pronën e kërkuar nga mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore në tetor 1999. Më pas paraqitësi i kërkesës konfirmoi se babai i tij e kishte shitur në të vërtetë pronën e kërkuar, por nuk ishte i kënaqur me shumën e çmimit të blerjes që kishte marrë. Komisioni vëren se në mungesë të kërcënimit në rrethanat e konfliktit, ai nuk ka juridiksion për rregullimin e çmimit të blerjes.

k. Kërkesa nr. 56109

38. Në kërkesën nr. 56109 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se parcela e kërkuar ishte shitur në vitin 2010 përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar dhe se ajo nuk ishte e interesuar në ndjekjen e kërkesës. Nuk është bërë tërheqje e kërkesës.

l. Kërkesat nr. 91511 dhe 91512

39. Në kërkesat nr. 91511 dhe 91512 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht stërnipit/stërmbesës së saj. Pala përgjegjëse pohoi se ai e kishte blerë pronën e kërkuar nga mbajtësi i së drejtës pronësore në vitin 2009. Më pas paraqitësi i kërkesës konfirmoi se babai i saj, djali i mbajtësit të së drejtës pronësore, në të vërtetë i kishte shitur pronat e kërkuara tek pala përgjegjëse, megjithatë ajo deklaroi se nuk kishte mundësi të tërheqë kërkesat pasi ajo jetonte jashtë shtetit.

m. Kërkesa nr. 92483

40. Në kërkesën nr. 92483 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht djalit të tij. Pala përgjegjëse pohon se e ka blerë pronën e kërkuar nga mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore në vitin 2003 dhe ka paraqitur në mbështetje të pretendimeve të tij, kontratën e blerjes të lidhur më 29 tetor 2003 për pronën e kërkuar midis palës përgjegjëse dhe mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Regjistrat kadastralë janë përditësuar në emër të palës përgjegjëse. Paraqitësi i kërkesës e mohon shitjen e pronës së kërkuar duke deklaruar se deklaratat e palës përgjegjëse nuk janë të vërteta. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës dështoi të ofrojë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij.

4. Res judicata

a. Kërkesa nr. 10469

41. Në kërkesën nr. 10469 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës kishte depozituar më herët kërkesë të kategorisë C në lidhje me të njëjtën pronë në Drejtoratin për Çështje Pronësore Banesore (DÇPB) me kërkesën nr. DS200490, dhe se pala përgjegjëse e kësaj kërkesë kishte paraqitur me herët kërkesë të kategorisë A për të njëjtën pronë në DÇPB me kërkesën nr. DS200338. Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore ("KKPB") me vendimin HPCC/D/236/2005/A&C datë 16 dhjetor 2005 e miratoi kërkesën e palës përgjegjëse nr. DS200338, duke i kthyer palës përgjegjëse të drejtën pronësore për pronën e kërkuar, ndërsa paraqitësit të kërkesës së kategorisë C iu miratua e drejta e kompensimit.

b. Kërkesa nr. 11795

42. Në kërkesën nr. 11795 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës ka depozituar më parë kërkesë të kategorisë A për të njëjtën pronë në DÇPB me kërkesën nr. DS201261. KKPB-ja me vendimin nr. HPCC/D/199/2005/A datë 18 qershor 2005 e refuzoi kërkesën e paraqitësit të kërkesës.

c. Kërkesa nr. 21033

43. Në kërkesën nr. 21033, kërkesa është depozituar nga përfaqësuesi i autorizuar i paraqitësit të kërkesës i cili kërkon në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës ka depozituar më herët kërkesë të kategorisë C për të njëjtën pronë në DÇPB me kërkesën nr. DS006428, ndërsa pala përgjegjëse e kësaj kërkesë kishte paraqitur me herët kërkesë të kategorisë B për të njëjtën pronë me kërkesën nr. DS001566. KKPB-ja me vendimin nr. HPCC/D/240/2005/B&C datë 16 dhjetor 2005 e hodhi poshtë kërkesën e paraqitësit të kërkesës dhe ia referoi atë gjykatës kompetente, ndërkohë e miratoi kërkesën e kategorisë B DS001566 për palën përgjegjëse.

d. *Kërkesa nr. 52351*

44. Në kërkesën nr. 52351 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës kishte depozituar më herët kërkesë të kategorisë C në lidhje me te njëjtën prone në DPÇB me kërkesën nr. DS005296, dhe se pala përgjegjëse e kësaj kërkesë kishte paraqitur me herët kërkesë të kategorisë B për të njëjtën prone në DÇPB me kërkesën nr. DS007464. Më pas KKPb-ja me vendimin nr. HPCC/D/155/2004/B date 22 tetor 2004, e refuzoi kërkesën e paraqitësit të kërkesës dhe ia referoi atë gjykatës kompetente ndërkohë miratoi kërkesën e palës përgjegjëse nr. DS007464.

45. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni mund të hedhë poshtë një kërkesë e cila është shqyrtuar dhe vendosur më herët në një vendim administrative ose gjyqësor i formës së prerë. Komisioni vëren se në pajtim me nenin 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 vendimet e formës së prerë të KKPb-së janë të detyrueshme dhe të zbatueshme dhe nuk i nënshtrohen rishikimit nga ndonjë organ administrativ ose gjyqësor në Kosovë. Rrjedhimisht, vendimi i mëparshëm i KKPb-së në këto çështje përbën çështje *res judicata*.

46. Komisioni konstaton se të gjitha kërkesat e përfshira në këtë seksion B duhet të hidhen poshtë për mungesë të juridiksionit për arsyet e përmendura më sipër.

C. *Kërkesa të refuzuara.*

47. Në bazë të nenit 8.6 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 Komisioni mund të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze. Kërkesat mund të refuzohen nga Komisioni nëse paraqitësi i kërkesës, ose mbajtësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, nuk kanë mundur të dëshmojnë interesin për drejtat e tyre pronësore dhe të shfrytëzimit për pronën e kërkuar.

48. Në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin nr 03/L-079, Komisioni ka kompetencë për të vendosur kërkesat e së drejtës pronësore ose të shfrytëzimit për pronën e paluajtshme. Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të marrë në konsideratë çfarëdo prova të besueshme, të cilat ai i konsideron të rëndësishme për kërkesën, përfshirë dëshmitë e paraqitura nga ana e Sekretarisë Ekzekutive lidhur me besueshmërinë e të dhënave publike. (Neni 6.2 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079). Komisioni mund të kërkojë nga Sekretariati për të marrë më shumë informacion nga një palë, ose për të kryer hetime shtesë në lidhje me ndonjë kërkesë (neni 6,3 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079). Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të drejtohet, por nuk është e detyruar nga rregullat e marrjes së dëshmive të aplikuara në gjykatat vendore në Kosovë (pika 6,1 të Aneksit III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079).

a. Kërkesa nr. 01130

49. Në kërkesën nr. 01130 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore për pronën e kërkuar. Paraqitësi i kërkesës pretendon se pronën e kërkuar ia ka shitur palës përgjegjëse në vitin 2000. Ai pohon se ka lidhur kontratë nën kërcënim dhe e ka shitur banesën e kërkuar për më pak se vlera e tregut. Paraqitësi i kërkesës konfirmon se banesa prej 56 m² është shitur për çmimin prej 76,000 DM.

50. Në bazë të nenit 4.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin 03/L-079, me kërcënim supozohet se vlera e tregut në kohën e shitjes nuk ka asnjë lidhje të arsyeshme me çmimin aktual të shitjes. Komisioni konstaton se çmimi i blerjes prej 76,000 DM për një banesë prej 56 m² nuk ka qenë i paarsyeshëm në kohën kur ka ndodhur transaksioni. Rrjedhimisht, nuk mund të konsiderohet se paraqitësi i kërkesës e ka bërë transaksionin nën kërcënim dhe kërkesa duhet të refuzohet.

b. Kërkesa nr. 10534

51. Në kërkesën nr. 10534 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore. Fillimisht paraqitësi i kërkesës kërkoi konfirmimin e së drejtës pronësore për pronën e kërkuar. Megjithatë, më pasi ajo pranoi se prona ishte shitur nga mbajtësi i së drejtës pronësore para konfliktit, në vitin 1997. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se për shkak të shëndetit jo të mirë ajo nuk pati mundësi të vijë në zyrat e AKP-së për të tërhequr kërkesën. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të refuzohet.

c. Kërkesa nr. 13705

52. Në kërkesën nr. 13705 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëshortit të saj. Paraqitësi i kërkesës pretendon se bashkëshorti i saj është bashkëpronar i banesës së kërkuar bazuar në kontratën për financimin për përfundimin e ndërtimit të banesës të lidhur midis Fondit të Zhvillimit të Serbisë dhe Departamentit të Kadastrës si bashkëinvestitor. Komisioni vëren se bashkëshorti i paraqitësit të kërkesës e ka nënshkruar kontratën në cilësinë e drejtorit të Departamentit të kadastrës si zyrtar nënshkrues. Rrjedhimisht, bashkëshorti i paraqitësit të kërkesës, në cilësinë e tij private, nuk ka qenë asnjëherë pale në kontratë dhe për rrjedhojë nuk rrjedhin të drejta pronësore nga kontrata që ai ka nënshkruar në cilësinë e përfaqësuesit të Departamentit të Kadastrës. Rrjedhimisht, në mungesë të të drejtave pronësore të dëshmuara nga ana e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, kërkesa duhet të refuzohet.

53. Paraqitësi i kërkesës paraqiti kërkesë në Sekretarinë Ekzekutive për përkthimin e dokumenteve që ishin paraqitur nga pala përgjegjëse i cili është uzurpuesi aktual. Kërkesa u refuzua nga Sekretaria, pasi paraqitësi i kërkesës dështoi të ofrojë dokumentacion të mjaftueshëm për të dëshmuar vështirësitë financiare. Paraqitësi i kërkesës kërkoi që Komisioni të rishqyronte vendimin e Sekretarisë Ekzekutive, megjithatë, në mungesë të ndonjë pretendimi ose dëshmie thelbësore të re, kërkesa e paraqitësit të kërkesës duhet të refuzohet.

d. Kërkesa nr. 13855

54. Kërkesa nr. 13855 u paraqit nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pretendon se e ka shfrytëzuar pronën e kërkuar nga dhjetori 1998 deri qershor 1999.

55. Pala përgjegjëse, i cili po e shfrytëzon pronën e kërkuar, kërkon të drejtë ligjore për pronën e kërkuar bazuar në vendimin e ndarjes të datës 11 janar 1978 me anë të të cilit, nënës së palës përgjegjëse, i është miratuar e drejta e pakufizuar e shfrytëzimit për pronën e kërkuar.

56. Sekretaria Ekzekutive nuk mundi të verifikojë dokumentet e ofruara nga paraqitësi i kërkesës në mbështetje të kërkesës së tij. Në këto rrethana, kërkesa duhet të refuzohet.

e. Kërkesa nr. 17897

57. Kërkesa nr. 17897 u paraqit nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit për pronën e kërkuar dhe riposedimin. Paraqitësi i kërkesës pretendon se banesa e kërkuar, i është ndarë atij për shfrytëzim të përkohshëm dhe se ai ka qenë në posedim të saj nga viti 1995 deri 1999, kur ai e humbi posedimin për shkak të konfliktit. Paraqitësi i kërkesës në mbështetje të kërkesës së tij, paraqiti vendimin e ndarjes të datës 14 shtator 1995.

58. Pala përgjegjëse, i cili aktualisht banon në banesë, pohon se fillimisht banoi me lejen e paraqitësit të kërkesës dhe më pas kërkoi lejë nga Komuna, e cila megjithatë nuk i është miratuar.

59. Komisioni vëren se prona e kërkuar i takon Komunës së Prishtinës dhe është regjistruar në kadastër si pronë në pronësi shoqërore. Komisioni vëren gjithashtu se vendimi i ndarjes i është lëshuar paraqitësit të kërkesës me afat të përkohshëm dhe paraqitësi i kërkesës asnjëherë nuk ka lidhur kontratë për shfrytëzimin për qëllimin e krijimit të së drejtës së përhershme të banimit për banesën e kërkuar. Në këto rrethana, Komisioni konstaton se e drejta e paraqitësit të kërkesës për të shfrytëzuar banesën, e cila ka qenë thjesht e drejtë ligjore e përkohshme ose e papërfunduar dhe si e tillë nuk mundëson rikthimin, mund të konsiderohet se i ka kaluar afati. Rrjedhimisht, në mungesë të së drejtës pronësore të miratuar, kërkesa e paraqitësit të kërkesës duhet të hidhet poshtë.

f. Kërkesa nr. 22267

60. Kërkesa nr. 22267 u paraqit nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Fillimisht paraqitësi i kërkesës kërkoi të drejtë pronësore për pronën, megjithatë, me pasi ai konfirmoi se nëna e tij ia kishte shitur pronën e kërkuar palës përgjegjëse në vitin 1974. Sipas paraqitësit të kërkesës, transaksioni nuk u formalizua asnjëherë, pasi familja e tij u largua nga Kosova në vitin 1975. Pala përgjegjëse konfirmon shpjegimet e paraqitësit të kërkesës dhe deklaroi se po shfrytëzon pronën e kërkuar për pothuaj 40 vjet. Në këto rrethana kërkesa duhet të refuzohet.

g. *Kërkesat nr. 28551 dhe 90953*

61. Kërkesat nr. 28551 dhe 90953 u paraqitën nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Të dy kërkesat janë paraqitur për të njëjtën pronë. Për të mbështetur pretendimet e saj, paraqitësja e kërkesës paraqiti “një vendim trashëgimie” datë 30 prill 2003 e lëshuar posaçërisht nga Gjykata Komunale paralele e Istogut në Serbi që konfirmon se paraqitësja e kërkesës ka trashëguar pronën e kërkuar nga vjehrra e saj. Komisioni nuk konsideron se këto dokumente vërtetojnë të drejtën e trashëgimisë. Komisioni vetë nuk ka juridiksion të zgjidhë çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë. Sekretaria Ekzekutive i kërkoi paraqitëses së kërkesës shumë here të ofrojë vendim trashëgimie të vlefshëm ose autorizim nga trashëgimtarët me qëllim që të procedohej me kërkesat, por ajo dështoi të paraqitë dokumentet e kërkuara. Në këto rrethana, duhet të konsiderohet se paraqitësja e kërkesës ka dështuar të vërtetojë të drejtën pronësore për pronën e kërkuar dhe kërkesa e saj duhet të refuzohet.

h. *Kërkesa nr. 28867*

62. Kërkesa nr. 28867 u paraqit nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore duke kërkuar pronësinë e pronës së kërkuar. Paraqitësi i kërkesës nuk ofroi dëshmi në mbështetje të kërkesës së tij. Atij iu kërkuar të dëshmojë kërkesën dhe të ofrojë dëshmi, megjithatë ai dështoi ta bëjë këtë.

63. Pala përgjegjëse, i cili aktualisht po shfrytëzon pronën e kërkuar, pohon se e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 2007 nga një person i tretë dhe paraqiti në mbështetje të pretendimeve të tij, kontratën e blerjes dhe fletën poseduese e cila e tregon atë si mbajtës të së drejtës pronësore. Kur u ballafaqua me pohimet e palës përgjegjëse nga Sekretaria Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës pranoi se prona e kërkuar ishte shitur tek pala përgjegjëse. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës dështoi të tërheqë kërkesën. Në këto rrethana, kërkesa duhet të refuzohet.

i. *Kërkesa nr. 29210*

64. Në kërkesën nr. 29210 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht nënës së tij. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se Komuna e Pejës i miratoi familjes së tij të drejtën e përkohshme të shfrytëzimit për pronën para konfliktit dhe ata e humbën posedimin e pronës në qershor 1999 kur u larguan nga Kosova për shkak të situatës së sigurisë. Paraqitësi i kërkesës nuk ofroi dëshmi të dokumentuara në mbështetje të pretendimeve të tij. Komisioni vëren paraqitësi i kërkesës ka depozituar gjithashtu kërkesë për të njëjtën pronë në DCPB me kërkesën nr. DS501076. Kjo kërkesë u refuzua nga KKP-bja me vendimin HPCC/D/204/2005/C më 18 qershor 2005. Megjithatë, Komisioni konsideron se vendimi i KKP-b-së nuk përben *res judicata* për synimin e kësaj kërkesë pasi mjeti ligjor i kërkuar nga paraqitësi i kërkesës para KKP-b-së ishte riposedimi ndërsa në këtë kërkesë paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit.

65. Pala përgjegjëse e cila është uzurpatori aktual i pronës, kërkon të drejtë ligjore duke pohuar se prona i ishte ndarë atij nga Qendra Komunale për Çështje Sociale në Pejë. Për të mbështetur pohimin e tij, ai paraqiti vendimin e ndarjes i cili u

vërtetua si i vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive. Në këto rrethana, kërkesa duhet të refuzohet.

j. Kërkesa nr. 36990

66. Kërkesa nr. 36990 u paraqit nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore, duke kërkuar konfirmimin e pronësisë për pronën e kërkuar. Paraqitësi i kërkesës pretendoi se banoi në banesën e kërkuar deri më 14 shtator 1999 kur ajo u zhvendos në Serbi për shkak të konfliktit. I vetmi dokument i rëndësishëm i paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në mbështetje të kërkesës është vendimi për shfrytëzimin e përkohshëm i lëshuar nga Komuna e Obiliqit. Ky vendim nuk u gjet nga Sekretaria Ekzekutive në regjistrat e Komunës kur ajo u përpoq të verifikonte dokumentin. Paraqitësit të kërkesës iu kërkuar të paraqitë dokumentacion shtesë për të vërtetuar të drejtën e pronësisë ose të shfrytëzimit për pronën e kërkuar, megjithatë paraqitësi i kërkesës nuk ka me dokumentacion tjetër.

67. Ndërtesa në të cilën ndodhej banesa e kërkuar është shkatërruar. Toka kryesore në të cilën ishte ndërtuar ndërtesa është tokë komunale. Ndërkohë është ndërtuar një xhami në vendin e ndërtesës së shkatërruar. Në këto rrethana, Komisioni konsideron se çfarëdo e drejtë ndarje e përkohshme që i është miratuar paraqitësit të kërkesës nga Komuna duhet të konsiderohet se ka i ka kaluar afati, se fundi kur është shkatërruar prona e kërkuar. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të refuzohet.

k. Kërkesa nr. 37219

68. Në kërkesën nr. 37219 paraqitësi i kërkesës paraqiti kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëshortit të saj. Paraqitësi i kërkesës pretendon se bashkëshorti i saj është pronari i pronës së kërkuar, megjithatë ajo pranoi se nuk ka asnjë dëshmi të rëndësishme në mbështetje të pretendimeve të saj, pasi atyre iu desh t'i lenë dokumentacionin në Kosovë kur u larguan nga Kosova.

69. Në mungesë të dëshmive në mbështetje të së drejtës pronësore për pronën e kërkuar, kërkesa duhet të refuzohet.

l. Kërkesa nr. 41455

70. Në kërkesën nr. 41455 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të saj. Fillimisht paraqitësi i kërkesës kërkoj konfirmimin e pronësisë për pronën e kërkuar. Komisioni vëren se vëllai i paraqitësit të kërkesës depozitoi kërkesë në AKP me kërkesën nr. 41538 për të njëjtën pronë. Gjatë përpunimit të kërkesës, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se vëllai i saj, pikërisht paraqitësi i kërkesës në kërkesën nr. 41538, është pronar i pronës së kërkuar bazuar në kontratën e ndarjes midis babait dhe vëllait të saj. Kërkesa nr. 41455 është miratuar me vendimin KPCC/D/R/151/2012. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se ajo nuk është e interesuar të ndjekë kërkesën. Rrjedhimisht, në mungesë të së drejtës pronësore nga ana e paraqitësit të kërkesës, kërkesa duhet të refuzohet.

m. Kërkesa nr. 44729

71. Në kërkesën nr. 44729 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore duke kërkuar konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit dhe riposedimin e pronës së kërkuar. Në mbështetje të pretendimeve të tij, paraqitësi i kërkesës paraqiti një vendim të ndarjes të vitit 1991. Sekretaria Ekzekutive nuk mundi të verifikojë vendimin e ndarjes. Rrjedhimisht, në mungesë të dokumenteve në mbështetje të së drejtës pronësore për pronën e kërkuar, kërkesa duhet të refuzohet.

n. Kërkesat nr. 44992 dhe 44993

72. Në kërkesat me nr. 44992 dhe 44993 fillimisht paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të saj. Më pas, paraqitësi i kërkesës deklaroi se ajo është bashkëpronare e pronës së kërkuar bazuar në vendimin e trashëgimisë date 20 gusht 2007, të lëshuar nga Gjykata Komunale e Kurshumlisë.

73. Pala përgjegjëse, i cili po e shfrytëzon aktualisht pronën e kërkuar, pretendon se i ka blerë pronat e kërkuara në vitin 1987, megjithatë, transaksioni nuk ka mundur të finalizohet në atë kohë për shkak të ndalimit ligjor të transaksioneve ndëretnike të pronave të paluajtshme. Paraqitësi i kërkesës e mohoi të ketë shitur pronën e kërkuar tek pala përgjegjëse. Në mars 2007, Gjykata Komunale e Podujevës ia njohu palës përgjegjëse të drejtat pronësore për pronën e kërkuar dhe pala përgjegjëse kërkoi që të bëhen ndryshimet në regjistrat kadastrale. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konstaton se pala përgjegjëse e ka blerë pronën e kërkuar në vitet 1980 dhe për rrjedhojë vendimi i trashëgimisë të Gjykatës së Kurshumlisë nuk përben bazë për t'u mbështetur kundër paraqitësit të kërkesës.

74. Rrjedhimisht kërkesa e paraqitësit të kërkesës duhet të refuzohet.

o. Kërkesa nr. 50464

75. Në kërkesën nr. 50464 paraqitësi i kërkesës e paraqiti kërkesën përmes përfaqësuesit të autorizuar në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Në mbështetje të pretendimeve të tij, paraqitësi i kërkesës paraqiti fletën poseduese nr. 829 të lëshuar nga kadastra e zhvendosur dhe një plan kadastral që e tregon Borivoje Mitic si mbajtësin e së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se e ka blerë pronën e kërkuar nga Borivoje Mitic, por nuk ka paraqitur asnjë dëshmi në mbështetje të transaksionit të pretenduar. Sekretaria Ekzekutive e gjeti *ex officio* certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 829 që e tregon Dragisa (Borivoj) Mitic si pronarin e pronës së kërkuar.

76. Në vitin 2009, në rrjedhën e procesit të verifikimit, Sekretaria Ekzekutive konstatoi se parcela e kërkuar ishte ndarë në nënparcela. Sekretaria e ka kontaktuar paraqitësin e kërkesës disa here dhe i kërkoi të ofrojë dokumente për të dëshmuar të drejtën pronësore, megjithatë ai dështoi ta bëjë atë. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet për mungesë të provave.

p. Kërkesat nr. 51116 dhe 51118

77. Në kërkesat nr. 51116 dhe 51118 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës nuk e ka identifikuar parcelën e kërkuar në formularin e pranimit të kërkesës. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës paraqiti një padi të datës 31 maj 2004 para Gjykatës Komunale të Pejës ku kërkon kompensimin për dëmet e pronës së tij të shkaktuara nga konflikti. Sipërfaqja e përcaktuar e pronës së kërkuar nuk përputhet me asnjë nga sipërfaqet e parcelave të shënuar në padi. Sekretaria i kërkoj disa here paraqitësit të kërkesës për të sqaruar vendndodhjen e saktë dhe sipërfaqen e parcelës së kërkuar, megjithatë, ai dështoi ta bëjë këtë.

78. Komisioni arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të vërtetojë çfarëdo të drejtë pronësore për parcelën e kërkuar. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet.

q. Kërkesat nr. 54575, 54576 dhe 54577

79. Në kërkesat me nr. 54575, 54576 dhe 54577 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Fillimisht, paraqitësi i kërkesës kërkoj riposedimin dhe kompensim, megjithatë me pas ai konfirmoi se pronat e kërkuara ishin shitur rreth 20 vjet me pare. Më tej, paraqitësi i kërkesës deklaroi se kontratat e blerjes nuk ishin vërtetuar dhe për rrjedhojë regjistrat kadastrale nuk janë përditësuar.

80. Rrjedhimisht, në mungesë të së drejtës pronësore gjatë periudhës përkatëse, kërkesa duhet të refuzohet.

r. Kërkesat nr. 92416 dhe 92417

81. Në kërkesat me nr. 92416 dhe 92417 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesat në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Fillimisht paraqitësi i kërkesës kërkoj riposedimin e pronave të kërkuara, megjithatë, më pas ai konfirmoi se pronat e kërkuara ishin shitur në vitin 1973.

82. Rrjedhimisht, në mungesë të së drejtës pronësore gjatë periudhës përkatëse, kërkesa duhet të refuzohet.

s. Kërkesa nr. 92434

83. Në kërkesën nr. 92434 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Paraqitësi i kërkesës kërkoj konfirmimin e pronësisë dhe riposedimin e pronës së kërkuar. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës dështoi të paraqitë dëshmi në mbështetje të të kërkesës. Rrjedhimisht në mungesë të së drejtës pronësore të dëshmuar, kërkesa duhet të refuzohet.

D. Kërkesa për kompensim

84. Në kërkesat me nr. 01130, 22267, 41455, 47602, 54575, 54576 dhe 54577 paraqitësi i kërkesës kërkon gjithashtu, përveç pronësisë, kompensimin për dëmin fizik të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesa të tilla. Rrjedhimisht kërkesa duhet të hidhet poshtë .

E. Vërejtje përmbledhëse.

85. Nisur sa më sipër, Komisioni konstaton se kërkesat e shënua në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur duhet të hidhen poshtë dhe kërkesat e shënuara në pjesët C dhe D të listës së bashkangjitur duhet të refuzohen dhe udhëzon të nxirret një urdhër në lidhje me secilin kërkesë ashtu si është përcaktuar më sipër.

86. Vendimi dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

87. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

(a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo

(b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze**

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part A/Pjesa A/Deo A

KPA00876	KPA13919	KPA22484	KPA50461	KPA56109	KPA92433	KPA42188
KPA50445	KPA50452	KPA50456	KPA22204	KPA47602	KPA92432	

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part B/Pjesa B/Deo B

KPA25547	KPA25548	KPA17897	KPA28989	KPA51022	KPA52351	KPA92434
KPA10469	KPA53704	KPA17078	KPA21033	KPA91511	KPA91512	KPA92483
KPA11795	KPA30669					

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part C/Pjesa C/Deo C

KPA50464	KPA28551	KPA41455	KPA90953	KPA51116	KPA51118	
----------	----------	----------	----------	----------	----------	--

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part D/Pjesa D/Deo D

KPA13705	KPA37219	KPA92416	KPA92417	KPA29210	KPA36990	KPA44992
KPA44993	KPA01130	KPA22267	KPA10534	KPA13855	KPA28867	KPA44729
KPA54575	KPA54576	KPA54577				